L I G J
Nr.7756, datë 11.10.1993

PËR SHTYPIN

Në mbështetje të neneve 16 e 20 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Neni 1
Liria e shtypit

Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj.
Shtypi kufizohet vetëm nëpërmjet dispozitave të kushtetutës dhe këtij ligji.
Ndalohet marrja e çdo mase tjetër që prek lirinë e shtypit.
Ndalohet themelimi i organizatave profesionale të shtypit me anëtarësi të detyruar dhe krijimi i gjykatave speciale për shtypin me pushtet diktues mbi të.

Neni 2
Liria e ushtrimit të shtypit

Veprimtaria e shtypit, ngritja e ndërmarrjeve të shtypit apo e çdo lloj ndërmarrjeje që ka të bëjë me të nuk kërkon paisjen me licencë.

Neni 3
Detyra publike e shtypit

Shtypi përmbush një detyrë publike, nëpërmjet hulumtimit përgatitjes dhe përhapjes së lajmeve, të prononcimit, të ushtrimit të kritikës apo mënyrave të tjera dhe është faktor ndikues për formimin e mendimit të lirë.

Neni 4
E drejta e shtypit për t'u informuar

Hallkat zyrtare janë të detyruara t'u japin përfaqësuesve të shtypit informacione, që i shërbejnë atyre për përmbushjen e detyrës publike.
Detyrimi për dhënie informacioni përjashtohet në rastet kur:
- Nëpërmjet tij mund të pengohet, vështirësohet apo rrezikohet ecuria e një procesi të filluar gjyqësor penal a civil.
- Kërkesa për informacion vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore për ruajtjen e sekretit.
- Dëmtohet një interes publik apo privat, që mbrohet me ligj.
Ndalohet nxjerrja e urdhërave të përgjithshme, që ndalojnë hallkat zyrtare t'i japin informacion shtypit në përgjithësi, atij të një drejtimi të caktuar apo një botimi periodik në veçanti.
Shtëpia botuese e një gazete apo reviste mund të kërkojë nga hallkat zyrtare, që informacioni i tyre zyrtar të mos jepet për përdorim më vonë se sa konkurentëve të tij.

Neni 5
Detyrimi i shtypit për vërtetësinë e informacionit

Shtypi detyrohet t'i verifikojë të gjitha lajmet para shpërndarjes së tyre në lidhje me vërtetësinë, përmbajtjen dhe burimin e tyre. Detyrimi për të ruajtur botimin e shtypit nga përmbajtje të dënueshme mbetet i paprekur.

Neni 6

Përcaktimi i termit "botim shtypi"

l. Botime shtypi në kuptimin e këtij ligji janë të gjitha shkrimet të përgatitura me anë të teknikës së shtypjes së librave apo teknikave të tjera të prodhimit në masë, të shumëfishimit apo shpërndarjes si dhe, shiritat e magnetofonit me incizim, regjistrues figure, vizatim me ose pa shkrim, gjithashtu pjesët muzikore me tekst apo shpjegime.

2. Në botime shtypi bëjnë pjesë edhe njoftimet e shumëfishuara, nëpërmjet të cilave agjencitë e lajmeve, korrespondentët e shtypit apo sipërmarrje të tjera furnizojnë shtypin me materialet e tyre në fjalë, figurë apo në mënyra të tjera të ngjashme. Si botim shtypi vlerësohen edhe njoftimet e dhëna nga një ndërmarrje ndihmëse redaksionale, pavarësisht nga forma teknike, në të cilën ato jepen.

Botime shtypi periodike janë gazeta, revista apo botime të tjera të shtypura që botohen vazhdimisht qoftë edhe në mënyrë jo të rregullt, por ndërmjet intervaleve kohorë jo më të gjata se gjashtë muaj.

3. Nuk quhen botime shtypi:

- materialet e shtypura zyrtare, derisa ato përmbajnë vetëm njoftime zyrtare;
- materialet e shtypura që i shërbejnë qëllimeve profesionale, qarkullimit, jetës private apo shoqërore, si formularë, lista çmimesh, njoftime familjare, materiale reklame, raporte biznesi vjetor, administrative apo të ngjashëm me to, si dhe fletët e votimit në zgjedhje.

Neni 7

Prezantimi i redaksisë

Të gjitha botimet e shtypit të publikuara në territoriin e Republikës së Shqipërisë duhet të ekspozojnë vendin dhe vitin e botimit,emrin ose firmën, adresën e botuesit, si dhe emrin dhe adresën e pronarit të tipografisë.

Përveç kësaj në botimet periodike duhet të vihen emri dhe adresa e redaktorit përgjegjës. Nëse ka më shumë redaktorë përgjegjës, duhet të ekspozohen të gjitha të dhënat për secilin prej tyre konform paragrafit 1. Në këtë rast duhet të bëhet e njohur se për cilën pjesë apo fushë të botimit është përgjegjës secili redaktor. Për pjesën e reklamës gjithashtu duhet të përcaktohet një përgjegjës; për të vlejnë të njëjtat rregulla si për redaktorin përgjegjës.

Gazeta ose shtesat e tyre, të cilat marrin të gatshme pjesë për botim, duhet të ekspozojnë emrin e redaktorit përgjegjës të pjesës së marrë dhe burimin e tyre. Gazetat dytësore apo shtesat, si ato lokale apo të kryeqytetit në prezantimin e tyre duhet të cilësojnë edhe botuesin e gazetës kryesore.

Neni 8

Kërkesat personale për redaktorin përgjegjës

1. Nuk mund të punojë në detyrën e redaktorit përgjegjës personi që:

- banon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- sipasojë e një vendimi gjyqësor nuk ka të drejtë të punojë në një post publikp
- nuk ka mbushur 18 vjeç;
- nuk mund të ndiqet në mënyrë të pakufizuar penalisht.

2. Rregullat e paragrafit l nr.3 nuk vlejnë për botimet e shtypit , të cilat publikohen nga të rinjtë për të rinjtë.

Neni 9

Cilësimi i publikimeve të shpërblyeshme

Në rast se botuesi apo përgjegjësi i një botimi të shtypit janë shpërblyer, kanë kërkuar apo kanë lejuar t'i premtohet shpërblim për një publikim, atëherë ky publikim, kur nuk botohet në vendin e caktuar për rubrikën e reklamave, duhet të cilësohet qartë me fjalën "reklamë".

Neni 10

Kërkesa për përgënjeshtrim

1. Redaktori përgjegjës dhe botuesi i një botimi periodik shtypi janë të detyruar të botojnë përgënjeshtrimin e një personi apo subjekti tjetër, të cilët janë prekur nga materiali i botuar. Detyrimi shtrihet në të gjitha botimet anësore apo gazetat dytësore të botimit të shtypit, ku është publikuar materiali përkatës.

2. Detyrimi për publikimin e përgënjeshtrimit përjashtohet në rastet kur:

a) personi apo subjekti nuk kanë interes të justifikuar për publikimin e tij,

b) përgënjeshtrimi nuk është i përshtatshëm për arsye të masës së tij, ose

c) bëhet fjalë për një reklamë që ka të bëjë vetëm me biznes.

Në rastet kur përgënjeshtrimi nuk e kapërcen masën e tekstit, të cilit i referohet, ai vlerësohet si i përshtatshëm.

Përgënjështrimi duhet të përmbajë vetëm të dhëna të vërteta dhe nuk lejohet të ketë përmbajtje të dënueshme. Ai duhet të dorëzohet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ligjor. I dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ligjor mund të kërkojnë publikimin e përgënjeshtrimit vetëm kur ai i është dorëzuar redaktorit përgjegjës apo botuesit jo më vonë se tre muaj mbas botimit të tekstit, të cilit i referohet.

3. Përgënjeshtrimi duhet të botohet menjëherë në numrin ende të papërgatitur për shtyp, në të njëjtin vend dhe me të njëjtin shkrim si të tekstit, të cilit i referohet, dhe pa shtesa apo reduktime. Ai nuk lejohet të botohet në formën e letrave të lexuesve. Shtypja e tij është gratis. Kush shprehet në formën e përgënjeshtrimit në të njëjtin numër, duhet të paraqesë vetëm fakte reale.

4. Për refuzimin e përgënjeshtrimit mund të ndiqet procedura e rregullt ligjore. Mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit gjykata mund të urdhërojë që redaktori përgjegjës ose botuesi të publikojnë përgënjeshtrimin konform paragrafit 3. Kjo procedurë kryhet sipas dispozitave të kodit të procedurës civile. Refuzimi i publikimit nuk kërkohet të vërtetohet. Për çështjen nuk zhvillohet proces gjyqësor.

5. Paragrafet 1 deri 4 nuk vlejnë për raportimet e mirëqena mbi seancat e Kuvendit Popullor apo të përfaqësive të komunave, bashkive, këshillave të rretheve si dhe të gjykatave.

Neni 11

Detyrimi i botuesve dhe Shtëpive botuese për dorëzim të botimit të shtypit

1. Për çdo botim të shtypit, që botohet në territorin e juridiksionit të këtij ligji, botuesi duhet t'i dorëzojë pesë kopje bibliotekave të mëposhtme me shpenzimet e veta dhe pa shpërblim.

a) Bibliotekës Kombëtare kur publikimi i botimit është kryer në Tiranë.

b) Bibliotekës së rrethit kur publikimi i botimit është kryer në shtypin lokal.

2. Përjashtohen nga detyrimi i dorëzimit botimet e shtypit të përcaktuar në nenin 6 paragrafi 2 si dhe paraqitjet në figurë pa tekst. Botimet e shtypit mund të përjashtohen nga ky detyrim.

3. Në rastet kur për shkak të tirazhit apo vlerës së madhe të botimit nuk mund të kërkohet nga botuesi dorëzimi i tij, bëhet kërkesa dhe zhdëmtohen shpenzimet e dorëzimit.

4. Paragrafët l deri 3 vlejnë përkatësisht edhe për ndërmarrjen që e shtyp botimin, në rastet kur botimi nuk ka botues në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kur ai zhvendoset jashtë territorit të veprimit të këtij ligji.

Neni 12

Urdhri për konfiskim

l. Konfiskimi i një botimi shtypi mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatësit.

2. Konfiskimi mund të vendoset vetëm në rastet kur:

- ekzistojnë arsye për tërheqjen e botimit të shtypit nga qarkullimi apo për rezervimin e tij dhe

- Tërheqja e botimit bëhet vetëm kur ekzistojnë arsye, mbi bazën e kërkesës përkatëse apo një autorizimi.

3. Konfiskimi nuk mund të urdhërohet, në rastet kur:

- rëndësia e interesit që mbrohet me masën e konfiskimit është më e vogël se vënia në rrezik e interesit publik për t'u informuar nga ky botim shtypi ose

- del qartë se dëmet që vinë nga konfiskimi nuk i përgjigjen rëndësisë së çështjes.

Neni 13
Masa e konfiskimit

1. Urdhri për konfiskim jepet vetëm për pjesët e botimit të shtypit, që gjenden në posedim të botuesit, publikuesit, redaktorit, shtypshkronjës, tregtarit, apo të personave të tjerë që kanë ndikuar në përgatitjen, publikimin dhe shpërndarjen e tyre, pjesët e shtypura të cilat janë ofruar botërisht apo janë shfaqur publikisht si dhe botime të shtypit të destinuara për shpërndarje apo shumëfishim; konfiskimi mund të shtrihet edhe mbi format e shtypit, pllakat e shtypit, matricet apo mjete të tjera përkatëse që janë bartëse të përmbajtjes së publikimit.

2. Në urdhrin për konfiskim duhet të përcaktohen pjesët e botimit të shtypit që duhen konfiskuar si dhe të cilësohen ligjet që janë shkelur nëpërmjet tyre. Pjesët që mund të shkëputen dhe që nuk kanë përmbajtje të dënueshme, nuk konfiskohen.

3. Konfiskimi i një botimi shtypi mund të anulohet, në rastet kur autori e tërheq vetë atë pjesë nga qarkullimi, nga shpërndarja apo shumëfishimi.

Neni 14
Kryerja e konfiskimit

1. Masat për kryerjen e konfiskimit duhet t'i përgjigjen rëndësisë së çështjes.

2. Konfiskimi kryhet duke vënë në dijeni me shkrim ose gojarisht personat e përmendur në nenin 13 paragrafi l fjalia l për arsyen e lëshimit të urdhrit të konfiskimit, duke i sqaruar edhe pasojat që vinë prej tij.

Neni 15
Ndalimi i shpërndarjes për botimet e shtypit të konfiskuara

Gjatë periudhës së konfiskimit nuk lejohet shpërndarja e botimit të konfiskuar si dhe rishtypja e pjesës që ka shkaktuar konfiskimin e tij.

Neni 16
Anullimi i konfiskimit

1. Urdhri për konfiskim mund të anulohet, kur brenda një muaji nuk është përpiluar akuza publike ose nuk është tërhequr vullnetarisht botimi nga qarkullimi.

2. Në rast se afati i parashikuar në paragrafin 1 nuk është i mjaftueshëm për shkak të gjerësisë së procesit apo të vështirësive në mbledhjen e provave, prokurori mund të kërkojë zgjatje afati edhe për një muaj tjetër. Kërkesa mund të përsëritet vetëm një herë.

3. Në rast se nuk është përpiluar aktakuza dhe as nuk është bërë kërkesa për tërheqje vullnetare nga qarkullimi, urdhri për konfiskim anulohet në momentin kur prokurori e kërkon vetë një gjë të tillë. Me paraqitjen e kërkesës së prokurorit, ndalimi sipas nenit 15 zhvleftësohet. Prokurori duhet të njohë të interesuarit me kërkesën e bërë.

Neni 17
Zhdëmtimi për konfiskim të pabazuar

l. Në rast se konfiskimi është i paligjshëm ose urdhri për konfiskim rezulton i pabazuar, i dëmtuari zhdëmtohet në të holla. Kjo shtrihet edhe në rastin kur urdhri për konfiskim mbetet në fuqi, edhe pse sipas nenit 16 ai duhej të anulohej.

2. Kërkesa për zhdëmtim mund të justifikohet, vetëm kur urdhri për konfiskim është anuluar si dhe kur nuk është lëshuar urdhër për tërheqje ose rezervim.

3. Zhdëmtimi bëhet për dëmet pasurore të ardhura nga konfiskimi.

4. Kërkesa sipas paragrafit 1 i drejtohet gjykatës së rrethit brenda një muaji nga shpallja e

vendimit të përmendur në paragrafin 2.

Neni 18
Sigurimi i përkohshëm

1. Prokurori apo ndihmësit e tij zyrtarë kanë të drejtë të tërheqin nga qarkullimi një botim për qëllime të ndryshme nga ato të sigurimit të provave edhe pa urdhër konfiskimi (sigurim i përkohshëm), në rastet kur nxjerrja apo shpërndarja e atij botimi përbën një vepër të kundërligjshme, e cila vërteton objektin e

- rrezikimit të paqes, rrezikimit të shtetit juridik demokratik, tradhtisë ndaj vendit, rrezikimit të sigurisë së jashtme ose
- të një vepre penale të parashikuar nga Kodi Penal;
- të shpërndarjes së shkrimeve që përbëjnë rrezik moral për rininë si dhe në rastet kur nuk mund të ekzekutohet në kohë një urdhër gjyqësor konfiskimi. Neni 12 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenet 13 dhe 17 mund të zbatohen edhe për sigurimin e përkohshëm.

2. Sigurimi i përkohshëm nuk zbatohet për gazetat ditore.

3. Vendimi gjyqësor për konfiskimin (neni 12) e një botimi shtypi, i cili gjendet në kushtet e sigurimit të përkohshëm, duhet të kërkohet nga prokurori brenda 24 orësh pas sigurimit.

Gjykata duhet të zgjidhë brenda 24 orëve, nga momenti i paraqitjes, kërkesën e prokurorit. Me vendimin e gjykatës për refuzimin e kërkesës për konfiksim, bie automatikisht edhe masa e sigurimit të përkohshëm.

4. Në rastet kur sigurimi i përkohshëm urdhërohet nga një ndihmëszyrtar i prokurorit, materialet paraqiten brenda 12 orëve tek prokurori.

5. Urdhri për sigurim të përkohshëm bie, në rastet kur vendimi i marrë nga organet përkatëse për konfiskim nuk paraqitet brenda 5 ditëve nga data e nxjerrjes së tij; botimi i shtypit i siguruar përkohësisht fiton menjëherë lirinë.

Neni 19
Konfiskimi për sigurimin e provave

Neni 12 deri 18 nuk zbatohen në rastet e konfiskimit të pjesëve të veçanta të një botimi shtypi për sigurimin e provave.

Neni 20
Përgjegjësia penale

1. Përgjegjësia për kryerjen e veprave penale nga një botim shtypi, përcaktohet nëpërmjet dispozitave të ligjit penal.

2. Në rast se botuesi i shtypit kryen një shkelje, që formon vepër penale përgjigjet penalisht:

- në rastin e botimeve periodike të shtypit redaktori përgjegjës dhe
- në botime të tjera botuesi, të cilët me dashje ose nga pakujdesia kanë shkelur detyrimin e tyre për të ruajtur botimin e shtypit nga kryerja e shkeljeve të dënueshme, ata dënohen me heqje lirie deri në një vit ose me gjobë, në rast se ata nuk konsiderohen autor ose bashkautor në vepër konform paragrafit 1.

Në rast se vepra e kundërligjshme e kryer nga botimi i shtypit dhe që formon vepër penale, mund të ndiqet vetëm me kërkesë apo autorizim, ndjekja e procesit sipas fjalisë 1 kryhet në bazë të përpilimit të kërkesës apo të autorizimit të lëshuar.

Neni 21
Shkelja e rregullave të shtypit

Me gjobë nga 100 000 - 800 000 lekë dënohet personi që:

- duke qenë botues cakton si redaktor përgjegjës një nëpunës, i cili nuk i përgjigjet kërkesave të nenit 8,
- nënshkruan me cilësinë e redaktorit pëgjegjës edhe në rastet kur nuk i përgjigjet kërkesave të

nenit 8,

- duke qenë redaktor përgjegjës apo botues i një botim shtypi me përmbajtje të kundërligjshme nuk respekton rregullat mbi prezantimin (neni 7),

- në kundërshtim me nenin 15 shpërndan ose rishtyp një botim shtypi të konfiskuar.

Neni 22

Shkelje të tjera të rregullave të shtypit

1. Veprojnë në kundërshtim me ligjin personat që me dashje apo nga pakujdesia

- duke qenë në detyrën e redaktorit përgjegjës apo botuesit nuk i përmbahen qoftë edhe një rregulli të nenit 7 mbi prezantimin, ose si ndërmarrje përhap botime shtypi, në të cilat mungojnë tërësisht apo pjesërisht të dhënat e përcaktuara në nenin 15 (Prezantimi)

- me detyrën botues apo përgjegjës (neni 7 paragrafi 2 fjalia 4), në kundërshtim me nenin 9, nuk e cilëson si reklamë një publikim me shpërblim, ose nuk ka lejuar të bëhet një gjë e tillë,

- shkel detyrimet e nenit 10 paragrafi 3 fjalia 3,

- shkel detyrimin për dorëzim sipas nenit 11 paragrafi l, edhe në lidhje me paragrafin 4.

2. Shkelja e këtyre rregullave gjobitet nga 10 000 - 800 000 lekë.

Neni 23

E drejta për të refuzuar dëshminë, ndalimi i konfiskimit dhe kontrollit

1. Redaktorët, gazetarët, botuesit, publikuesit, shtypshkronjat dhe të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në përgatitjen dhe publikimin e një botimi shtypi periodik, kanë të drejtë të refuzojnë dhënien e dëshmisë në lidhje me botuesin, korrespondentin apo personin garant të një publikimi në pjesën redaksionale të botimit të shtypit apo të një njoftimi të dhënë për publikim, si dhe për përmbajtjen e tij.

2. Ndalohet konfiskimi i materialeve të shkruara, i shiritave të zërit apo regjistruesve të figurës, pamjeve ose paraqitje të ndryshme, që gjenden në posedim të refuzuesit të dëshmisë apo të redaksisë, botuesit a shtypshkronjës, në rastet kur konfiskimi urdhërohet për qëllime hetimi, apo vërtetimi të fakteve, mbi të cilat shtrihet e drejta për refuzimin e dëshmisë.

3. Në lidhje me kontrollin ka efekt paragrafi 2.

4. Në rastet kur personi që ka të drejtën e refuzimit, dyshohet si autor apo bashkëpunëtor i një vepre penale, në rrethanat dhe rastet e ngutshme, refuzimi nuk ka vlerë.

Neni 24

Dispozita kalimtare

1. Çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

2. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.667, datë 26.10.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.